

Znj. Lolita Baholli është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, me rezultate të larta, në vitin 1985.

Nga viti 1985 deri në vitin 1992, ka punuar si ekonomiste/ financiere në ndërmarrje nacionale.

Prej muajit maj 1992 deri në shkurt 2006, ka punuar si audituese e lartë në Kontrollin e Lartë të Shtetit në departamente të ndryshme të auditimit.

Nga muaji shkurt 2006 – tetor 2013 ka punuar Inspektore - Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në Kryeministri.

Prej tetor 2013 e në vazhdim ka punuar si audituese e lartë dhe kryeaudituese në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Aktualisht është në pozicionin Kryeauditueses në Departamentin e Auditimit të Performancës.

Ka një eksperiencë të gjatë audituese, kualifikime cilësore brenda dhe jashtë vendit në SAI, gjykata llogarish si dhe me organizata ndërkombëtare të auditimit, në fushën e auditimit, planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, standartet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, trajnimit për trajnerë, prokurimeve publike, riskut të auditimit, kontabilitetit, antikorrupsionit, etj.

Në vitin 2008 ka marrë titullin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” dhe në vitin 2015 është diplomuar në IT Audit nga Projekti “IDI” – Indi.